

URDHËR
Nr. 233, datë 7.6.2012

**PËR MIRATIMIN E FORMËS SË STUDIMIT, ME KOHË TË PJESSHME TË PROGRAMEVE
TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” TË UNIVERSITETIT
“EQREM ÇABEJ” TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 24 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin në universitetin “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës të formës së studimit me kohë të pjesshme, të programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” në:

a) Mësuesi, për arsimin e mesëm të ulët në “Histori-gjeografi”, me profil minor në “Edukatë qytetare”;

b) Mësuesi, për arsimin e mesëm të ulët në “Gjuhë-letërsi”, me profil minor në “Gjuhë italiane”;

c) Mësuesi, për arsimin e mesëm të ulët në “Matematikë-fizikë”, me profil minor në “Aftësim teknologjik”;

d) Mësuesi, për arsimin e mesëm të ulët në “Biologji-kimi”, me profil minor në “Edukim mjedisor e teknologjik”;

e) Kontabilitet-financë;

f) Administrim-publik;

g) Turizëm.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional” me kohë të pjesshme, të pikës 1 të këtij urdhri, të fillojnë në vitin akademik 2012-2013.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Eqrem Çabej” të Gjirokastrës, pa efekte buxhetore shtesë.

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj